

VENDIM
Nr. 768, datë 19.12.2025

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I RRUGËS ‘ZEF SEREMBE’, BASHKIA TIRANË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i rrugës ‘Zef Serembe’, Bashkia Tiranë”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Tiranë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 5 850 194.10 (pesë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e katër pikë dhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 5 850 194.10 (pesë milionë e tetëqind e pesëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e katër pikë dhjetë) lekësh përballohet nga Bashkia Tiranë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Tiranë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues, për likuidim, pranë Bashkisë Tiranë.

8. Bashkia Tiranë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Tiranë.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Tiranë, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Tiranë, për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE, E PRONARËVE PASURITË E PALUAJTSHME PRONË PRIVATE E
TË CILËVE, SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“NDËRTIMI I RRUGËS ‘ZEF SEREMBE’”, BASHKIA TIRANË

Nr.	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (IPAS KARTELËSË PASURISË)								VLERËSIMET PËR SHIPRONËSIM						VLERë TOTALE (LEKË)	SHËNIME				
												TRUALL			ARË								
	Emër	Aftësia	Mbiemër	Qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtese (m²)	Volum	Faqe	Sipërfaqja (m²)	C'mimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	C'mimi (lekë/m²)			Vlera (lekë)			
1	Bujar	Kadri	Rexhepi	Tiranë	8110	3/445	Truall	405.40	405.40	103.30	8	230	67.8	23,703	1,607,063.40	0	0	0	1,607,063.40				
2	Selman	Mverteza	Qendria	Tiranë	8110	3/539	Arë	1,550	0	0	7	76	0	0	0	90.6	448	40,588.80	40,588.80				
3	Pranvera Naime	Batjari	Shabani Bali	Tiranë	8110	3/555	Truall	3,242.00	3,242	1,118.50	10	136	128.1	23,703	3,036,354.30	0	0	0	3,036,354.30				
4	Ismail	Ismail	Allushi	Tiranë	8110	3/462	Truall	365.90	365.90	110.20	9	111	6.5	23,703	154,069.50	0	0	0	154,069.50				
5	Adrian	Yehvi	Mangaj	Tiranë	8110	3/566	Truall	150	150	12.00	10	161	23.06	23,703	71,109	0	0	0	71,109.00				
6	Rafit	Kadri	Rexhepi	Tiranë	8110	3/608	Truall	305	305	101.70	11	221	39.7	23,703	941,009.1	0	0	0	941,009.10				
Vlera totale																							5,850,194.10